

RADIO
TELEVISIONI
SHQIPTAR

KËSHILLI DREJTUES I RTSH
NR/493 PROT

Tirane me 22.05.2020

VENDIM
Nr. 18, Datë 22.05.2020

Në zbatim të nenit 102 pikat 2/ç të ligjit nr 97/2013, datë 04.03.2013 “ Për median audiovizive ne RSH”, nenit 17 të vendimit të Kuvendit të Shqiperisë nr 98, datë 22.12.2016 “ Për miratimin e Statutit të RTSH”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH me shkresat nr 1352 prot, datë 04.05.2020 dhe nr. 1462 prot, date 21.05.2020, mbi disa ndryshime në strukturën organizative të Departamentit të Prodhimit dhe në Librin e Pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH, Këshilli Drejtues i RTSH në mbledhjen e tij të datës 22.05.2020, me votimin pro të 6 anëtarëve të pranishëm K.Traja, S.Kumbaro, H.Haliti, A.Shegani, XH.Mato, dhe Xh.Aliu;

VENDOSI:

I. Të miratojë disa ndryshime në Strukturën Organizative të Departamentit të Prodhimit dhe në Librin e Pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH -së, si më poshtë vijon:

A) NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE

- Të shtohet 1 (nje) vend pune në emërtesën “Montazhier lajme” në Sektorin e Montazhit në Departamentin e Prodhimit të RTSH.
- Të shtohet 1 (nje) vend pune në emërtesën “Montazhier sporti” në Sektorin e Montazhit në Departamentin e Prodhimit të RTSH.
- Të shtohet 1 (nje) vend pune në emërtesën “Montazhier i emisioneve ne studio” në Sektorin e Montazhit në Departamentin e Prodhimit të RTSH.
- Të shtohet 1 (një) vend pune në emërtesën “Kameraman i emisioneve ne terren” në Sektorin e Kameraneve në Departamentin e Prodhimit të RTSH.
- Në Strukturën organizative të Sektorit të Regjisorëve në Departamentin e Prodhimit të RTSH-së, 1 (një) vend pune në emërtesën “Asistent prodhimi (Organizator)” të ndryshohet në emërtesën “Asistent prodhimi”.


B) NDRYSHIME NË LIBRIN E PAGAVE

Address: "Ismail Qemali" Street, No.11, Tirana, Albania

Phone: + 355 4 22 27 512
Fax: + 355 4 22 27 745
e-mail: info@rtsh.al

www.rtsh.al





RADIO
TELEVIZIONI
SHQIPTAR

- Të hiqet nga klasën e VI e Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH, emërtesa “Redaktor (Përkthyes)” dhe të shtohet në klasën e VII të librit të pagave të kësaj Drejtorie.
- Të hiqet nga klasën e VIII e Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH, emërtesa “Përgjegjëse e Sektorit të Përkthimit në Departamentin e Prodhimit” dhe të shtohet në klasën e IX të librit të pagave të kësaj Drejtorie.
- Të shtohet në klasën e VII të Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH emërtesa “Asistente prodhimi”.

Numri i vendeve të punës në Strukturën Organizative të Departamentit të Prodhimit të RTSH-së për vitin 2020 ndryshon në 174.

II. Ky vendim hyn në fuqi një datë 01.06.2020.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH

Kristaq TRAJA

Address: "Ismail Qemali" Street, No.11, Tirana, Albania

Phone: + 355 4 22 27 512
Fax: + 355 4 22 27 745
e-mail: info@rtsh.al

www.rtsh.al

